



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government**

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

**PËRGJIGJE PËR PYETJET MË TË SHPESHTA NË LIDHJE ME THIRRJEN PUBLIKE
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË NMVM-VE NË
SEKTORIN E INDUSTRIJËS KREATIVE**

- 1. Cili është dokumenti bazë që vërteton ekzistencën ligjore të ndërmarrjes?**
Përgjigje: Certifikata e regjistrimit të ndërmarrjes me të gjitha informatat përcjellëse sipas legjislacionit në fuqi.
- 2. Kur nuk kërkohet certifikata e veçantë për numrin fiskal?**
Përgjigje: Kur numri i regjistrimit të ndërmarrjes dhe numri fiskal janë në një certifikatë të vetme.
- 3. Si dëshmohet që ndërmarrja nuk ka borxhe tatimore?**
Përgjigje: Përmes një vërtetimi tatimor nga ATK që tregon se nuk ka borxhe tatimore të pashlyera ose që është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit.
- 4. Cili dokument përdoret për të përcaktuar kategorinë e ndërmarrjes dhe pikët për punësimin e grave? Përgjigje:** Lista e punëtorëve për vitin 2024, e lëshuar nga ATK, që përfshin emrin e ndërmarrjes dhe NUI-në.
- 5. Cili dokument personal kërkohet nga përfaqësuesi i ndërmarrjes?**
Përgjigje: Kopje e letërnjoftimit të personit në emër të të cilit është regjistruar ndërmarrja.
- 6. Si dëshmohet që ndërmarrja nuk është në falimentim ose nën administrim gjyqësor?**
Përgjigje: Me dëshmi nga Gjykata Themelore, jo më e vjetër se 30 ditë, në formë origjinale.
- 7. Si dëshmohet që ndërmarrja ka një xhirollogari aktive?**
Përgjigje: Përmes dëshmisë së xhirollogarisë aktive në një bankë të licencuar nga BQK.

8. A kërkohet pasqyra e gjendjes së llogarisë bankare?

Përgjigje: Për vitin 2024 – përveç nëse ndërmarrja është e sapo themeluar në 2025.

9. Çfarë përmban oferta për realizimin e projektit?

Përgjigje: Shpenzimet që domosdo duhet të bëhen me subjekte tjera afariste (të jashtme).

10. Si dëshmohet që aktivitetet e projektit nuk janë financuar nga burime të tjera?

Përgjigje: Përmes deklaratës nën betim, e shkarkuar nga faqja e KIESA-së dhe e ngarkuar në e-Kosova.

11. Si dëshmohet që ndërmarrja ka përmbushur detyrimet nga financimi i mëhershëm publik?

Përgjigje: Me deklaratë nën betim që dëshmon përmbushjen e detyrimeve ndaj MINT për dy vitet e fundit.

12. A kërkohet qarkullimi financiar për vitet e kaluara?

Përgjigje: Po. Ndërmarrjet e regjistruara para 2023 sjellin qarkullimin për vitet 2023 dhe 2024. Ndërmarrjet e regjistruara pas vitit 2023 sjellin qarkullimin që nga regjistrimi. Ndërmarrjet e regjistruara në vitin 2025 sjellin qarkullimin nga data e regjistrimit.

13. Çfarë përmban projekt propozimi dhe si dorëzohet?

Përgjigje: Formulari për Projekt Propozim shkarkohet nga faqja e KIESA-së, plotësohet dhe ngarkohet në e-Kosova. Ai duhet të përfshijë:

- Pasqyrën e veprimtarisë së biznesit
- Qëllimin dhe konceptin inovativ të projektit
- Aktivitetet dhe rezultatet e pritshme
- Kostot dhe burimet financiare
- Strukturën organizative dhe objektivat
- Kapacitetet aktuale dhe synimet e rritjes

14. A është e detyrueshme paraqitja e një video-propozimi?

Përgjigje: Po, kërkohet një video deri në 2 minuta që përshkruan konceptin e projektit, e ngarkuar përmes një linku në e-Kosova (nga Youtube, Google Drive, Vimeo, One Drive ose DropBox).

15. Cilat janë disa nga kategoritë e shpenzimeve të pranueshme për mbështetje financiare?

Përgjigje: Shpenzimet e pranueshme përfshijnë:

- Blerjen e pajisjeve dhe teknologjisë
- Materialet dhe furnizimet për prodhim
- Brendim dhe marketing
- Përmbajtje krijuese
- Materiale të specializuara
- Pjesëmarrje në panairë, ekspozita, festivale, rrjete
- Shpenzime për eksport

16. A ka kufizime për aktivitetet promovuese në buxhetin e projektit?

Përgjigje: Po, aktivitetet promovuese nuk duhet të kalojnë 30% të buxhetit të kërkuar.

17. Si duhet të planifikohen dhe justifikohen shpenzimet në aplikim?

Përgjigje: Të gjitha shpenzimet duhet:

- Të planifikohen me kujdes sipas kohëzgjatjes së projektit
- Të justifikohen qartë në aplikim
- Të mbështeten me dokumentacion të vlefshëm, si: kuota dhe/ose oferta.

18. Cilat janë disa nga shpenzimet që nuk pranohen për financim?

Përgjigje: Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- Qiratë për hapësira pune
- Pagat e stafit administrativ
- Shpenzimet operative të zakonshme
- Çdo shpenzim i bërë **para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit**

19. Kush e verifikon buxhetin përfundimtar të projektit?

Përgjigje: Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për verifikimin e buxhetit të miratuar përfundimtar.

20. Në cilat gjuhë duhet të plotësohet aplikacioni dhe buxheti?

Përgjigje: Aplikacioni dhe buxheti duhet të plotësohen online në platformën e-Kosova, në shqip, serbisht, ose anglisht.

21. A mund të aplikojë një ndërmarrje që ka përfituar nga ndonjë skemë e KIESA-së në 2023 ose 2024?

Përgjigje: Jo. Ndërmarrjet që kanë përfituar nga skemat e KIESA-së në vitin 2023 apo 2024 nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje në vitin 2025, përjashtuar vetëm skemën për shërbime të digjitalizimit.

22. A mund të diskualifikohet aplikacioni nëse mungon një dokument?

Përgjigje: Po. Çdo aplikacion që mungon qoftë edhe një dokument të kërkuar, do të diskualifikohet.

23. A mund të aplikojë një ndërmarrje e regjistruar pas hapjes së thirrjes?

Përgjigje: Jo. Ndërmarrjet e regjistruara në ARBK pas hapjes së thirrjes publike diskualifikohen automatikisht.

24. A lejohen ndryshime në ARBK gjatë fazës së aplikimit ose pas përzgjedhjes së përfituesve?

Përgjigje: Jo. Ndryshimet në ARBK nuk lejohen gjatë fazës së aplikimit apo pas shpalljes së listës preliminare, deri në realizimin e pagesës.

25. Si përzgjidhen ndërmarrjet përfituese?

Përgjigje: Ndërmarrjet përfituese përzgjidhen sipas pikëve të vlerësuara nga komisioni. Mund të ketë deri në 10 ndërmarrje rezervë në varësi të buxhetit.

26. A lejohen kompani konsulente të përfaqësojnë ndërmarrjet aplikuese?

Përgjigje: Jo. Kompanitë konsulente që përfaqësojnë ndërmarrjet do të diskualifikohen,

sepse procesi është obligim i Ndërmarrjes për të aplikuar dhe dëshmuar se ka potencial dhe ide. Procesi është i thjeshtë, pa kosto, dhe plotësisht online.

27. A ka ndonjë shpenzim të rimbursueshëm para nënshkrimit të marrëveshjes?

Përgjigje: Jo. Asnjë shpenzim i realizuar para nënshkrimit të marrëveshjes nuk është i arsyetueshëm/pranueshëm.

28. Çfarë obligimi kanë ndërmarrjet përfituese para nënshkrimit të marrëveshjes?

Përgjigje: Ato duhet të dorëzojnë garancion nga bankë ose kompani sigurimi, për vlerën e plotë të mbështetjes financiare.

29. Kur transferohen fondet për projektin?

Përgjigje: Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese i transferohen 100% e vlerës së aprovuar, brenda një afati prej 14 ditësh.

30. A është TVSH shpenzim i pranueshëm?

Përgjigje: Jo, për ndërmarrjet deklaruese të TVSH-së.

31. Duke qenë se fondet sigurohen nga UNDP, a lirohet kompania nga dogana për pajisjet e blera jashtë Kosovës?

Përgjigje: JO. Zbatimi i Instrumentit Financiar realizohet nga KIESA, prandaj aplikohen të gjitha taksat sipas ligjeve, dhe rregulloreve në fuqi.

32. Si duhet të dëshmohen shpenzimet gjatë implementimit të projektit?

Përgjigje: Me fatura, kontrata dhe transaksione bankare, në përputhje me ofertën e paraqitur në projekt-propozim.

33. Çfarë ndodh nëse aplikacioni përmban të dhëna të pasakta?

Përgjigje: Ndërmarrja nuk përfiton dhe do të mbajë përgjegjësi ligjore për të gjitha pasojat.

34. Çfarë ndodh nëse një kategori nuk plotëson kuotën?

Përgjigje: Mjetet e pashpenzuara mund të shpërndahen në kategoritë tjera sipas nevojës. MINT/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

35. Kohëzgjatja dhe Zbatimi i Projektit

Përgjigje: Afati maksimal për realizimin e projektit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Obligimi për raportim: Bizneset duhet të raportojnë të paktën 30 ditë para skadimit të marrëveshjes.

36. A ekziston kushti që ndërmarrjet të kenë qarkullim vjetor mbi 30 mijë euro për të qenë të kualifikuar për këtë fond?

Përgjigje: Jo. Në kuadër të kësaj thirrje nuk ekziston ky kusht.

37. A lejohet aplikimi nga konsorciume me dy ose më shumë kompani?

Përgjigje: Jo. Në kuadër të kësaj thirrjeje për mbështetje financiare, aplikimet nga konsorciume kompanish nuk lejohen.